



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS NË FUSHË KOSOVË

Numri i lëndës: 2020:096863

Datë: 29.09.2023

Numri i dokumentit: 04735182

C.nr. 3597/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Qëndresa Beqiri Murati, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. H nga Vushtrria, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K. F, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale për Arsim me seli në Obiliq, me objekt kontesti kompensimin e pagës jubilarë dhe pagesën e shujtave, jashtë seancës, me datë 29.09.2023 mori këtë:

AKTGJYKIM

- I. APROVOHET E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit A. H nga Vushtrria, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit, në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 28.02.2021, gjithsej 530 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 1,060.00 euro, si dhe në emër të kompensimit për shpërbllim jubilar për 20 vite të përvojës së punës në vlerë prej 75% të një page bazë, t’ia kompensoj shumën prej 315.75 euro, shuma e përgjithshme prej 1,591.75 euro.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit t’ia paguaj kamatën në lartësi prej 8% për pjesën e aprovuar të padisë, nga data e paraqitjes së kërkesëpadisë datë 13.08.2020, e deri në pagesën e tërësishme, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësi A. H nga Vushtrria, përmes të autorizuarit të tij, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 13.08.2020 ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Obiliq, për kompensimin e shujtave ditore dhe pagës jubilarë. Paditësi, në padi, ndër të tjera, ka theksuar se është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura dhe atë në pozitën e mësimitdhënësit në SH.F.M.U “H...” në , dhe se ka mbi 17 vite përvojë pune në këtë shkollë, andaj edhe i ka plotësuar kushtet për realizimin e 75% të një page bazë ashtu siç

parashihet me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, e hyrë në fuqi me datë 18.04.2017. Tutje ka theksuar se e paditura nuk ia ka paguar as shujtën për ushqim ditor, ashtu siç përcaktohet në kontratën në fjalë.

Përmes parashtresës së dorëzuar në gjykatë me datë 28.04.2023, kërkesën e padisë e ka precizuar ashtu që nga gjykata ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të shujtës ditore për ushqim, për 530 ditët e pranisë në punë, t'ia kompensojë shumën prej 1,060.00 euro, si dhe në emër të shpërblimit jubilar për mbi 20 vite të përvojës së punës, duke llogaritur sipas pagës bazë që realizon paditësi, shumën prej 315.75 euro, e në total shumën prej 1,375.75 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën e përgjithshme prej 229.00 dhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro, përpilimin e parashtresës për precizimin e padisë shumën prej 104.00 euro, si dhe për taksë gjyqësore për padi shumën prej 21.00 euro.

E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, duke theksuar se e paditura nuk ka obligim ndaj paditëses pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 17.04.2017, e në nenin 37 të së cilës është përcaktuar se *“Palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe ti respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”*, e që rrjedhimisht e paditura nuk është përgjegjëse për të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga kjo kontratë. Tutje ka theksuar se e paditura nuk ka obligim e as të drejtë të bëjë ndarje buxhetore për këto lloje të kompensimit, e duke shtuar se neni 90, paragrafi 5 i Ligjit të Punës, ka përcaktuar se *“Marrëveshja kolektive vlen vetëm për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*, dhe se e paditura nuk ka marrë përsipër detyrimet e kësaj kontrate. Andaj, bazuar në të dhënat si më lart, i ka propozuar gjykatës, që padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pabazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimin të përgjigjes në padi, dhe parashtresës së datës 28.04.2023, mbi precizimin e padisë, e të cilën palës së paditur gjykata ia ka dorëzuar me datë 23.08.2023, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, porse e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit dhe mungesës së përgjegjësisë së të njëjtës për përmbushjen e këtij detyrimi, si dhe faktin se e njëjta nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit. Në këtë rast kontestues është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance.

Nga provat e bashkangjitura padisë gjykata gjeti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, sipas kontratës së punës të datës 25.01.2016. Gjykata përmes vërtetimit mbi përvojën e punës me numër të protokollit 114/21, i datës 23.03.2021 gjeti se paditësi ka 23 vite përvojë pune, ndërsa nga vërtetimi me numër protokollit 145/21, i datës 12.02.2021, gjykata gjeti se i njëjti në periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 28.02.2021 ka qenë gjithsej 530 ditë prezentë në punë.

Faktin e lartësisë së pagës së paditësit gjykata e vërtetoi përmes listës së pagës, ku përcaktohet pagat bazë. Neni 329 par. 1 i LPK-së ka përcaktuar se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën*

e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Së këndejmi, provave që kishin të bënin me vërtetimin e fakteve lidhur me ditët e prezencës në punë, lartësisë së pagës si dhe përvojën e punës, gjykata ua fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Nga provat e cekura si më lartë, gjykata gjeti se paditësit A. H për 20 vite përvojë pune nuk i është paguar shpërblimi jubilar në vlerë të 75 % të një page bazë, kompensim ky i paraparë me nenin 35 paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, ku është përcaktuar se punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit dhe atë: për 10 vite të përvojës së punës, në vlerë të 50 % të një page bazë; për 20 vite të përvojës së punës, në vlerë të 75 % të një page bazë... Së këndejmi, nga gjendja faktike e vërtetuar rezultoi se i padituri ka detyrimin e pagesës së pagës jubilarë, në vlerë të 75% të pagës bazë që ka realizuar paditësi.

Në padi, paditësi ka theksuar se nuk ka pranuar kompensimin në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë, në kohën sa ka qenë në fuqi KKAK. Nga vërtetimi i datës 12.02.2021, me numër protokollit 145/21, lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë, gjykata gjen se paditësi ka qenë 530 ditë prezent në punë, prandaj gjykata ditët e kaluara në punë të paditësit i ka shumëzuar me nga 2 euro, rrjedhimisht duke i njohur shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Këtë lloj kompensimi gjykata ia njohu paditëses në harmoni me nenin 35 par.7, të KKAK-së i cili ka përcaktuar se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2(dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”*

Gjykata duke ju referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, dispozitat e së cilës aplikohen në tërë Republikën e Kosovës, ku në nenin 35 është paraparë e drejta punëtorëve të arsimit në shpërblim jubilar dhe kompensim në emër të ushqimit, gjeti se e njëjta është e aplikueshme nga hyrja në fuqi me datë 18.04.2017. Pas skadimit të kësaj kontrate, është nxjerrë kontrata e re, e cila iu garanton punonjësve të arsimit këto të drejta.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit aprovues jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar dhe për ushqime gjatë punës, i njëjti është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësi e ka rolin e kreditorit, kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili ka përcaktuar se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me*

ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij". Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj shumën si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata, pretendimet e të paditurës të ngritura përmes përgjigjes në padi se nuk kanë linjë buxhetore të ndarë për pagesën e pagave jubilarë i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditësi në rrugë gjyqësore ka filluar të realizojnë një të drejtë ligjore që i garanton KKAK, kurse mungesa e linjës së veçantë buxhetore të të paditurës, si dhe pretendimi se e njëjta nuk është përgjegjëse për faktin se nuk është palë nënshkruese e kësaj kontrate, nuk mund të ketë për efekt vendosjen ndryshe.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit "*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*". Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni ka përcaktuar se "*Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*", e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë datë 13.08.2020.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitivin nga neni 452 të LPK - së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara në shumë prej 124.00 euro i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë, në shumë prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore për padi në shumë prej 20.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka qenë jo e plotë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.3597/2020, datë 29.09.2023

Gjyqtarja
Qëndresa Beqiri Murati

KËSHILLË JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*